

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregulator
Dt.30.01.2021*

30.01.2021

Ora 11:00

RENDI I DITËS


**Projektakti “Për miratimin e Metodologjisë së Monitorimit të Medias audio dhe
audiovizive”**

PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
- Ilirjan CELIBASHI Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Komisioni Rregulator:**
- Ilirjana NANO Kryetar
- Arens ÇELA Anëtar
- Dritan CAKA Anëtar
- Helga VUKAJ Anëtar
- Muharrem ÇAKAJ Anëtar
- Stafi KQZ Y.Merkaj
- Parti Politike LSI
- **Vëzhgues:**

Znj.I.Nano: Mirmëngjes! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregulator, të pranishëm 5 anëtarët e Komisionit Rregulator, i pranishëm Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve zoti Celibashi, të pranishëm përfaqësues të partive politike dhe zyrtarë të administratës së Komisionit Qendor të Zgjedhjeve. Të nderuar kolegë jemi në platformën Webex, ndoshta ka ndonjë problem teknik, do tiu kërkoja që të keni zërin të mbyllur dhe vetëm kur të merrni fjalën të bëjmë një tentivë, jemi në rregull. Atëhere mbledhja e Komisionit Rregulator, sot zhvillohet me këtë rend dite kemi për shqyrtim dhe miratim projekt-vendimin: “Për miratimin e

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*



Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së

Komisioni Rregulator


Dt.30.01.2021

metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive". Është një nga vendimet më të rëndësishme që vijnë për shqyrtim në Komisionin Rregulator në këtë periudhë, jemi duke iu afuar fillimit të fushatës zgjedhore ku në këtë periudhë intesifikohen edhe detyrat e shumë organeve të cilat në fakt Kodi Zgjedhor i ngarkon me detyra, dhe pikërisht në këtë rast, bëjnë fjalë për AMA-n për Autoritetin e Mediave Audivizive, të cilat sipas ndryshimeve të Kodit Zgjedhor ka detyrimin për të monitoruar mediat audio dhe audiovizive gjatë fushatës zgjedhore gjithashtu AMA ka edhe detyrat për monitorim edhe gjatë periudhës 4 muaj para zgjedhjeve sa i përket ndjekjes së zbatimit të vendimeve të Komisionerit për veprimtaritë e ndaluara të administratës shtetërore për tu mos u transmetuar në operatorët apo në mediat audio dhe audiovizive. Sigurisht ky akt është një hov i ri cilësor në rregullimet e mëhershme ku deri në zgjedhjet e kaluara ishte Bordi i Monitorimit të Medias ai që zhvillonte monitorim sot i është ngarkuar me ndryshimet në Kodin Zgjedhor i është ngarkuar Autoritetit të Mediave Audiovizive. Atëhere, për më tepër lidhur me projekt-vendimin unë do të ftoja Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve zotin Ilirjan Celibashi për të prezantuar aktin dhe në mënyrë të përbledhur relacionin. Zoti Celibashi keni fjalën!

Z.I.Celibashi: Mirmëngjes! Faleminderit zonja Nano!

Kam përshtypjen që prezantimi i këtij projekt-akti do marri pak më shumë kohë se herët e tjera kjo edhe për vetë rëndësinë që ky akt pasi implikon interesa si të operatorëve audiovizual po ashtu edhe të subjektve zgjedhore pjesmarrëse në fushatë dhe mendoj që ndoshta do të ishte në interes për të dyja palët mësë pari por edhe për oponionin publikë të kishin disa informacione më shumë në lidhje me përbatjen e këtij akti. Pa dyshim që akti për përcaktimin e rregullave për metodologjinë e monitorimit të medias, për procedurën e shqyrtimit të raporteve

*Zbardhi materialin e incizuar
Ardita VRIONI*



Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së

Komisioni Rregulator

Dt.30.01.2021

dhe për vendosjen e masave qortuese apo ndëshkimore nga Komisioni Qendor i Zgjedhjeve kundrejt ofruesve të shërbimeve mediatike audio dhe/ose video është përcaktuar si akt normativ nga Kodi Zgjedhor. Duke qenë një akti i tillë bazuar në nenin 12 pika 4 dhe nenin 20 pika 1 të Kodit Zgjedhor, Komisioni Rregulator është organi kompetent i Komisionit Qendor i Zgjedhjeve për ta miratuar këtë akt. Kodi Zgjedhor ka përcaktuar përgjegjësinë e autoritetit të mediave audio vizive pra të AMA-s për monitorimin e mbulimit të fushatës zgjedhore 30 ditore nga ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe video. Kodi ka përcaktuar gjithashtu që këtë monitorim AMA ta bëj bazuar në një metodologji të caktuar, metodologji e cila miratohet nga Komisioni Qendor i Zgjedhjeve dhe specifisht nga Komisioni Rregulator. Pikërisht ky është edhe qëllimi i këtij akti pra përcaktimi metodologjisë së monitorimit të medias nga autoriteti i AMA-s. AMA nëpërmjet kësaj metodologjie gjatë fushatës zgjedhore duhet që të sigurojë sipas përcaktimeve të këtij akti që liria e shprehjes të jetë thelbësore dhe e garantuar në vlerësimin dhe mbulimin e fushatës zgjedhore nga operatorët mediatik audio dhe vizual, që këto operatorë të mbulojnë plotësisht kriteret të respektojnë të gjitha kriteret për një raportim të ekuilibruar pluralist dhe të pa anshëm, në raste ankesash evidentimin e plotë mbi përdorimin e gjuhës urretjes dhe përmbatjes së standardeve profesionale të etikës gazetareske nga ana e këtyre operatorëve. Mundësimin e aksesit të barabartë dhe të ndershëm të kandidatëve, subjekteve zgjedhore dhe platformave të tyre elektorale. Monitorimi i fushatës zgjedhore prej operatorëve kryhet në të gjithë territorin e vendit ku zhvillohen zgjedhjet. AMA e monitoron zbatimin e rregullave të sanksionuara në Kodin Zgjedhorë dhe të akteve nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij dhe kryesisht në bazë dhe zbatim të këtij akti. Radio Televizioni Publik Shqipëtar (RTSH) dhe operatorët e tjerë mediatik privat janë të detyruar që të regjistrojnë të gjitha transmetimet e tyre gjatë


*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*



Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregulator
Dt.30.01.2021

fushatës zgjedhore. Regjistrimet ruhen për një periudhë 10 mujore edhe pas përfundimit të zgjedhjeve dhe vihen në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me kërkesë të këtij institucioni. Monitorime operatore mediatik publik bëhet sipas këtyre kritereve për rastin kur operatorët publik kanë një shtrirje gjeografike kombëtare satelitore dhe rajonale që mbulojnë minimalisht 48% të popullsisë, bazohet ky monitorim në këto kriterë, monitorimi i përditshëm i TV-ve në format gjeneralist dhe informativ. Monitorimi i përditshëm i edacioneve informative, reklamave spoteve, debateve politike apo programeve të përcaktuara në nenin 8-të të këtij vendimi, kur janë të ftuar përfaqësues të subjekteve politike dhe/ose zgjedhore kandidatë për deputet, drejtues të organeve të njësive të qeverisjes vendore dhe të tjerë. Monitorimi bëhet në të dhëna sasiore dhe cilësore sipas mundësive teknologjike të AMA-s, referuar kërkesave të Kodit Zgjedhorë dhe akteve nënligjorë të KQZ-së. Monitorimi i operatorëve publik me shtrirje rajonale që nuk plotësonjë kriterin e pikës a, bëhet me përzgjedhje në bazë të këtyre kritereve: zona e ofrimit të shërbimit mediatik, pra mbulimit gjeografik, audiencia, oraret e transmetimit, për formatin dhe përmbytjen e programeve të transmetuara nga këto operatorë, lloji i medias, audiencia e synuar nga kjo lloj media në publik dhe aktorët politikë. Monitorimi i operatorëve audiovizual privat bëhet sipas këtyre kritereve: në rastin kur këta operatorë kanë një shtrirje gjeografike kombëtare satelitore dhe rajonale që mbulojnë minimalisht 48% të popullsisë bëhet bazuar në këto kriterë: Monitorimi i përditshëm i televizioneve me format gjeneralist dhe informativ, monitorimi i përditshëm i edacioneve informative, i reklamave spoteve, debateve politike, apo i programave të përcaktuara në nenin 7-të të këtij vendimi, ku janë të ftuar përfaqësues të subjekteve politike dhe atyre zgjedhore, kandidat për deputet, drejtues të organeve të njësive të qeverisjes vendore. Monitorimi bëhet në të dhëna sasiore dhe cilësore

Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI



Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së

Komisioni Rregulator

Dt.30.01.2021

sipas mundësive teknologjike të AMA-s referuar kërkesave të Kodit Zgjedhorë dhe akteve nënligjore të KQZ-së. Monitorimi i operatorëve privat me shtrirje rajonale të cilët nuk plotësojnë kriterin e pikës a, të ilustruar , të përmendur , të shtjelluar me sipër bëhet me përzgjedhje në bazë të këtyre kritereve: zona e ofrimit të shërbimit pra mbulimit gjeografik, audiencia, oraret e transmetimit, formatin e përbajtjeve të transmetuara nga operatori i përgjithshëm tematik, lloji i medias, audiencia e synuar nga kjo lloj media në publik dhe aktorët politik. Risi në këtë projekt-akt është parashikimi i monitorimit të operatorit publik dhe privat duke kategorizuar sipas natyrës së tyre pra publik dhe privat. Përzgjedhja për operatorët për tu monitoruar është e bazuar në dy metoda: Ajo e monitorimit të gjithë operatorëve që janë në shtrirje gjeografike kombëtare dhe satelitore, si dhe atyre rajonale të cilët mbulojnë minimalisht 48% të popullsisë dhe për pjesën tjetër me kampionaturë. Ky kriter është zgjedhuar duke u bazuar në një vlersim paraprak të kushteve të përcaktuara në pikën 2, të nenit 55, të ligjit 97, të vitit 2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”,sipas të cilit licensat kategorizohen rajonale për mbulim deri në 4 qarqe, me vazhdimësi gjeografike. Duke marrë në konsideratë këtë kriter janë vlersuar 3 akse me shtrirje gjeografike si më poshtë:

- 1.Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Korçë me numër të përafërt popullsie prej rreth 2.4 milion dhe me numër mandatesh në këto qarqe 75.
- 2.Tiranë , Elbasan, Berat dhe Vlorë me numër të përafërt popullësie 2.2 milion dhe numër mandatësh të prodhuara në këto qarqe 69.
- 3.Shkodër, Lezhë, Tiranë dhe Durrës me numër të përafërt popullësie 2.1 milion dhe me numër mandatesh të prodhuara në këto qarqe 68 mandate.

Ky përcaktim u përzgjodh për shkak se kampionatura është përfaqësuese në shtrirje gjeografike dhe domethënëse për ndikimin që mundet të ketë media në

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*




Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së

Komisioni Rregulator

Dt.30.01.2021

popullatë për shkak të shikueshmërisë dhe shtrirjes së saj. AMA me qëllim monitorimin e të gjithë operatorëve bazuar në kapacitetet dhe mundësitë teknike të operatorëve të cilët do të monitorohen, do ti rekomandojë çdo të Hënë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve numrin e kanaleve të operatorit që do të monitorohen dhe do të shpjegojë arsyet e kësaj përzgjedhje. Në zonat kryesore gjeografike të populluara nga pakicat e kombëtare, AMA monitoron operatorët lokal në bazë të përzgjedhjes sipas pikës 3 të këtij akti. Operatorët lokal që nuk mbulohen nga mjetet monitoruese, AMA iu kërkon atyre ruajtjen e programacionit dhe dërgimin e regjistrimeve në mënyrë elektronike në Dvd ose Cd. dhe dërgimin e regjistrimeve në mënyrë elektronike, në DVD ose në CD. Programet që monitorohen, ndahen sipas kategorive të mëposhtme: Edicionet e zakonshme dhe të posaçme informative, transmetimet e drejtpërdrejta në kohë reale, spote reklama, titrimet bazuar në kampionatur në dy orë transmetimi për televizionet informative, debate zgjedhore, programe të tjera me përbajtje informative, programe me përbajtje të ndryshme, ku ftohen politikanë, të cilët përcjellin mesazhet politike gjatë transmetimit të këtyre programeve. AMA përpilon raportet ditore për monitorimin e fushatës zgjedhore të operatorëve dhe ia dërgon ato Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili publikon ato në faqen zyrtare. Raporti i monitorimit sasior është ditor dhe pasqyron të dhënrat e regjistrimeve të asaj dite, dhe depozitohet pranë KQZ-së, jo më vonë se ora 10:00, e ditës së nesërme të regjistrimit. Raporti depozitohet në dy kopje, i printuar ose në formatin elektronik. AMA i pasqyron gjetjet e veta në raporte të detajuara, minimalisht një herë në javë, të cilat i paraqet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për kompetencë. Përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore kanë të drejtë të depozitojnë komente dhe propozimet e tyre para KQZ-së, në lidhje me raportin. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve urdhëron korrigimin e sjelljes së operatorëve ose të subjekteve, sipas

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*




*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregulator
Dt.30.01.2021*

rastit dhe vendos sanksione administrative ndaj tyre, mbështetur në gjetjet e veta, në ato të raporteve të monitorimit si dhe në informacionet, ankimet apo denoncimet e palëve të treta, të verifikuara prej tij. Subjektet e monitoruara në bazë të raporteve ditore paraqesin pranë AMA-s, kërkesat për rishikim të treguesve të monitoruar. Kërkesat duhet të jenë të argumentuara dhe të mbështetura në fakte dhe në prova. AMA, jo më vonë se dy ditë nga paraqitja e kërkesës për rishikim, trajton kërkesën duke pranuar korrigjimet e treguesve ose refuzimin e kërkesës. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrton raportet e monitorimit jo më pak se një herë në javë, gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Subjektet zgjedhore apo palët e treta që kanë pretendime, ankesa për periudhën që përfshin rapporti që është shqyrtuar, duhet t'i depozitojnë ato në KQZ, përpara fillimit të mbledhjes së radhës. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në përfundim të shqyrtimit administrativ të raporteve të auditimit, vendos për pranimin ose refuzimet, rekondimet të monitorimit. KQZ kryesisht ose me propozim të AMA-s, vendos edhe marrjen e masave administrative ndaj operatorëve që na shtrijnë dispozitat e këtij Kodi Zgjedhor. Vendimi i KQZ-së, pra respektivisht i Komisionerit Shtetëror përbën titullin ekzekutiv, ankimi nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit. Pak a shumë, apo gjatë, pasqyruar gjatë, këto ishin elementët kryesorë të këtij projektakti. Fjala është për ju për ta shqyrtuar. Faleminderit zonja kryetare!

Znj.I.Nano: Falenderojmë, Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve për paraqitjen! Në fakt, të zgjeruar të plotë do të thaja të këtij...rëndësisë që siç u theksua deri tani, ka. Kështu që unë në këtë moment do të çelja diskutimin në parim lidhur me projektvendimin...e Metodologjisë së Monitorimit të Medias audio dhe audio-vizive. Më së pari u drejtohem kolegëve, anëtarëve te Komisionit Rregulator dhe më tej përfaqësuesve të partive politike. Të nderuar kolegë! Me sa shoh, kolegët,

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregulator
Dt.30.01.2021*

anëtarët e Komisionit Rregulator nuk kanë diçka për të diskutuar në parim. Eshtë një akt që në fakt ka marrë vemendjen e duhur, kohën e duhur nga Komisioneri, administrata apo edhe nga anëtarët e Komisionit Rregulator. Nëse jo, po ia kaloj fjalën, kemi vetëm përfaqësuesin e partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, zotin Kaziaj. Zoti Kaziaj, keni diçka në parim rreth projektaktit?

Z.A.Kaziaj, përfaqësuesi i LSI: Përshëndetje e nderuar! Nuk kemi asgjë në parim. Eshtë një akt kompleks. Eshtë në të mirë të gjithëve domethënë. Gjithë partive në qoftë se, monitorimi do të jetë sipas...që do të japim...Të kaloj sa me shpejt norma e komisionit.

Znj.I. Nano: Në rregull,faleminderit! Atëherë, të nderuar kolegë, ju ftoj të votojmë në parim projektvendimin për “Miratimin e Metodologjisë së Monitorimit të Mediave audio dhe audio-vizive”

Kush është dakord me projektvendimin në parim, ju lutem?

Pro: 5 (zpj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zpj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Atëherë, me pesë vota pro, miratojmë në parim, projektvendimin. Kalojmë në diskutimin nen për nen. Më lejoni, ndjesë, ndoshta do t'u kërkoja kolegëve, në rregull. Për shkak se Komisioneri e paraqiti të plotë projektvendimin, nëse dhe kolegët janë dakord me mua, t'i kalojmë, pra të bëjmë diskutim dhe votimin për nenet, një nga një, pa e lexuar përbajtjen e secilit nen. Janë 15 nene të projektvendimit. Pra do të lexoj titullin e nenit.

Z. D. Çaka: Unë personalisht, jam dakord me propozimin tuaj, zonja kryetare!

Z.M. Çakaj: Dakord!

*Zbardhi materialin e incizuar
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregulator
Dt.30.01.2021*

Z.A. Çela: Dakord!

Znj.I. Nano: Në rregull, faleminderit! Atëherë, nis me nenin 1. Objektivat dhe qëllimet. Po i drejtohem së pari zotit Kaziaj, nëse ka ndonjë propozim për shtesë apo ndryshim, me tej anëtarët e Rregulatorit?! Nuk kemi!

Kolegët, lidhur me nenin 1, “objektivat dhe qëllimet e projektaktit”? Me sa shoh nuk kemi. Atëherë kalojmë për votim, nenin 1 të projektvendimit. Kush është pro?

Kush është dakord?

Pro: 5 (zpj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zpj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Dakord, me pesë vota pro, miratohet nenin 1 i projektvendimit. Neni 2, “Fusha e veprimit”. Përsëri për procedurë, zoti Kaziaj, ose më mirë, nëse keni diçka zoti Kaziaj, ju lutem kërkon fjalën në ndonjë nen, konkret. Atëherë, nuk keni diçka për nenin 2. Të nderuar kolegë, për nenin 2? Kalojmë në votim nenin 2, Fusha e veprimit të projektvendimit,

Kush është dakord?

Pro: 5 (zpj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zpj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka


Miratohet!

Me pesë vota pro, miratohet nenin 2 i projektvendimit. Neni 3 i projektvendimit, janë “Përkufizimet”. Janë pikërisht AMA, OSHMA, lloji i medias, kampionaturë, kandidatët të caktuar që përmenden edhe më së shumti në këtë projektvendim. Nëse dikush dëshiron fjalën për koment, propozim konkret për shtesë apo ndryshim, është i lirë ta bëjë? Nëse jo, kalojmë për votim nenin 3, “Përkufizimet”.

Kush është dakord me këtë nen?

Pro: 5 (zpj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zpj.Vukaj, z.Çakaj)

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregulator
Dt.30.01.2021*

Kundër: S'ka

Miratohet!

Atëherë me pesë vota pro, miratohet nenı 3. Neni 4, "Monitorimi i publikimit të sondazheve"? Nëse ka diçka konkrete për nenin 4, për dy pikat e tij? Qoftë nga anëtarët e rregulatorit, qoftë nga përfaqësuesit e partive politike? Nëse jo, ju ftoj të votojmë nenin 4, "Monitorimi i publikimit të sondazheve".

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Me pesë vota pro, miratohet nenı 4, "Monitorimi i publikimit të sondazheve". Vijojmë me nenin 5, "Monitorimi i transmetimit të veprimtarive të ndaluara nga KQZ". Sikundër u theksua edhe në fillim të kësaj mbledhjeje edhe gjatë fjalës së Komisionerit, kemi të bëjmë edhe me një veprimitari tjeter të AMA-s, pra jo vetëm me monitorimin në fushatë zgjedhore të operatorëve dhe transmetimeve të tyre, por edhe me monitorimin më herët, pra katër muaj para zgjedhjeve të veprimtarive që ndalojen nga KQZ-ja. Pra të ndaluara me urdhër të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Nëse ka ndonjë koment apo propozim për shtesë a ndryshim në nenin 5? Nuk kemi! Atëherë ju ftoj të votojmë nenin 5, të nderuar kolegë.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Me pesë vota pro, miratohet nenı 5, "Monitorimi i transmetimit të veprimtarive të ndaluara nga KQZ". Neni 6, "Monitorimi i fushatës zgjedhore". Monitorimi i fushatës zgjedhore u trajtua në mënyrë të detajuar nga Komisioneri, është në fakt

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregulator
Dt.30.01.2021*

një nen i gjatë që përfshin qoftë kriteret për monitorimin e OSHMA-ve, me shtrirje gjeografike kombëtare. Monitorimin e OSHMA-ve me shtrirje rajonale, monitorimin e OSHMA-ve private, e të tjera. Janë pesë pika ku kriteret kryesore janë zona afrimi të shërbimit, mbulimi gjeografik, audiencia, oraret e transmetimit, formati i përbajtjeve, lloji i medias, audiencia e synuar, etj. Atëherë, të nderuar kolegë dhe përfaqësues të partive politike nëse keni komente, propozime për shtesa apo për ndryshime për nenin 6, ju lutem? Mesa shoh nuk ka propozime, atëherë, kalojmë në votimin e nenit 6, “Monitorimi i fushatës zgjedhore”.

Kush është dakord me nenin 6, me përbatjen sipas propozimit të Komisionerit?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet!


Me pesë vota pro, miratohet nenii 6. Neni 7 janë, Kategoritë e programeve që monitorohen nga AMA. Duke patur parasysh si edicionet e zakonshme apo të posaçme informative, transmetimet live, spote, reklama, titrimet, debatet zgjedhore, programet me përbajte investigative informative apo programet ku ftohen politikanë dhe përcjellin mesazhe politike. Nëse ndonjë nga kolegët apo nga përfaqësuesit e partive politike kanë komente apo propozime konkrete, janë të ftuar. Mesa shoh jo, kështu që duhet të kalojmë në votim dhe nenin 7, me titull, “Programet që monitorohen nga AMA.” Të nderuar kolegë! ***Kush është dakord?***

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet! Me pesë vota pro, miratohet nenii 7, “Programet që monitorohen nga AMA.”

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregulator
Dt.30.01.2021*

Znj.I.Nano: Neni 8! Monitorimi i ofruesve të shërbimeve mediatike vendore, ku detyrohen këto OSHMA vendore të depozitojnë pranë AMA-S, përmbajten ne transmetuar në fillim të çdo dite pasardhëse. Kemi ndonjë koment, propozim për shtesë, ndryshim? Kalojmë për votim nenin 8 me titull monitorimi i ofruesve të shërbimeve mediatike vendore,

Kush është dakord të nderuar kolegë?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka!

Me 5 vota pro, miratohet nenin 8.

Neni 9, përmbajtja e raportit të monitorimit, e cila siç u thkesua bën fjalë për raportin me të dhëna sasiore por edhe për raporte me të dhëna cilësore, të cilat janë të gjithë rubrikat që duhet të përmbajë raporti i AMA-s. Zoti Kaziaj, të nderuar kolegë nëqoftëse keni ndonjë koment lidhur me nenin përkatës, nenin 9 apo propozim për shtesa apo ndryshime. Faleminderit! Atëherë ftoj kolegët të votojnë nenin 9, përmbajtja e raportit të monitorimit.

Kush është dakord me këtë nen?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka!

Atëherë me 5 vota pro miratohet dhe nenin 9, përmbajtja e raportit të monitorimit.

Neni 10, paraqitja e raporteve të monitorimit. U trajtua më herët në mënyrë të zgjeruar procedura. Mënyra si paraqiten raportet në KQZ nga ana e AMA-s, qoftë raportet ditore që thamë, janë raporte me karakter sasior, qoftë raportet javore që janë me karakter cilësor. Të nderuar kolegë, përfaqësues të partive politike kemi ndonjë diskutim, propozim, koment, vërejtje për nenin 10? Po Z. Çaka?

*Zbardhi materialin e incizuar
Romina Kokoshi*



Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Rregulator
Dt.30.01.2021

Z.D.Çaka: Besoj që nuk është një propozim por thjesht për pjesën gjuhësore ose për teknologjinë e saktë, tek pika 8 e nenit 10, pas togfjalëshit Komisioneri Shtetëror të shtohet edhe fjala i Zgjedhjeve, nuk është propozim është thjesht plotësim, është i vetmi, pra për të dhënë definicionin e plotë, siç e ka dhe Kodi Zgjedhor, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Znj.I.Nano: Faleminderit Z.Çaka! Pra të nderuar kolegë, sikurse dhe Z.Çaka e tha nuk është propozim që do duhet të votohet, është një korigjim që duhet bërë nga ana e administratës gjatë zbardhjes së vendimit, pra në pikën 8 të nenit 10 pas fjlaës Komisioneri Shtetëror të shtohet i Zgjedhjeve.

Dakord, të nderuar kolegë kemi diçka tjetër?

Atëherë kalojmë në votimin e nenit 10, me titull paraqitja e raporteve të monitorimit në KQZ.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka!

Miratohet nenii 10.

Kalojmë në nenin 11, rishikimi administrativ i monitorimit. Ju lutem kolegë dhe ndoshta z.Çaka, se interfenoj, ndoshta duhet të ulni zërin. Atëherë lidhur me nenii 11 kemi ndonjë koment, ju lutem, propozim? Nuk kemi. Atëherë kalojmë në miratimin e nenit 11, të nderuar kolegë, anëtarë të Rregulatorit.

Kush është dakord me nenin 11?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka!

Faleminderit me 5 vota pro miratohet nenii 11.

Zbardhi materialin e inçizuar
Romina Kokoshi



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Rregulator
Dt.30.01.2021*

Neni 12, Shqyrtimi i raportit të monitorimit. Ky nen bën fjalë për prezantimin në mbledhje publike para Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Zoti Çaka shikoj që ka kërkuar fjalën. Po?

Z.D.Çaka: Besoj që është edhe kjo thjesht gjuhësore, por për të qenë edhe më korrekt, duke qenë se ne po miratojmë nenet konkrete. Tek pika 1, besoj që duhet të ketë një ndryshim të vendit, aty ku thotë, përfaqësuesi i AMA-s prezanton favor raportin besoj duhet të jetë prezanton raportin favor. Është thjesht gjihësore, thjesht ndryshimi i fjalaës, për të qenë dhe më korrekte me procesverbalin e zgjedhjeve. Faleminderit!

Znj.I.Nano: Dakord. I mbetet administratës për të bërë këtë korigjim. Keni ndonjë koment apo propozim në lidhje me nenin 12? Nëse jo, kalojmë në votim. Votojmë nenin 12, shqyrtimi i raportit të monitorimit.

Kush është dakord me përbajtjen e nenit sipas propozimit të Komisionerit?

Pro: 5 (zpj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zpj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka!

Me 5 vota pro miratohet nenii 12!

Neni 13, paraqitja e raportit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Në këtë nen bëhet fjalë për shqyrtimin e raporteve javore të monitorimit, depozitim e ankesave nga subjektet zgjedhore apo palët e treta dhe pranimin ose jo, pra vendimarjen e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve lidhur me pranimin apo jo të rekomandimeve, vendosjen apo jo të masave administrative, këto janë pak a shumë dispozitat e nenit 13. Të nderuar kolegë, të nderuar përfaqësues të partive politike, nëse kemi diçka lidhur me nenin 13? Atëherë kalojmë në votimin e nenit 13, paraqitja e raportit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Të nderuar kolegë,

*Zbardhi materialin e inçizuar
Romina Kokoshi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Rregulator
Dt.30.01.2021*

Kush është dakord me nenin 13, ju lutem, të votojmë?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka!

Me 5 vota pro miratohet nenii 13!

Neni 14 lidhet me ankimin ndaj vendimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda 3 ditësh në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, është parashikimi i Kodit Zgjedhor. Kemi ndonjë koment për nenin 14? Znj.Vukaj?

Znj.H.Vukaj: Ndjesë znj.Nano, po shikoj në fakt në nenin 13, ndoshta është një lapsus sepse nuk ka uniformitet me pikat më lart, pika 4. Ku në të gjithë pikat thuhet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndërsa, ndoshta për inerci të së kaluarës është ruajtur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në pikën 4 dhe pikën 5. Ndërkohë që për uniformitet dhe për kompetencë të Komisionerit duhet Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, sepse është i vetmi që ka këtë atribut. Ky është një lloj rregullimi në fakt, dhe nuk po e konsideroj si propozim.

Znj.I.Nano: Faleminderit znj.Vukaj. Unë do ta shtroja për votim në fakt propozimin tuaj, duke mos e konsideruar thjesht një korigjim sikundër ato që thamë më parë. Kështu që propozimi i znj.Vukaj është që në pikën 4 dhe 5 të nenit 13, togfjalëshi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, të zëvendësohet me Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Jam korrekte me propozimin?

Znj.H.Vukaj: Korrekt, nëse do ta quajmë propozim, me argumentin se autoriteti i vetëm që ushtron vendimarrjen në këtë fushë është Komisioneri dhe jo KQZ-ja, sepse mbetet pa, i përgjithshëm dhe pa funksion, në këtë rast.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Romina Kokoshi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregulator
Dt.30.01.2021*

Znj.I.Nano: Dakord! Atëhere votojmë propozimin e znj.Vukaj! Pika 4 dhe 5 e nenit 13, Komisioni Qendoror i Zgjedhjeve, të zëvendësohet me Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Kush është dakord ju lutem?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka!

Me 5 vota pro miratohet propozimi i znj.Vukaj!

Rikthehem i tek neni 14, me ankimin ndaj vendimeve të, gjithashtu këtu do të propozoj edhe unë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, znj.Vukaj, në të njëjtën linjë me sa më sipër dhe ju,

Z.D.Çaka: Në titull, besoj.

Znj.I.Nano: Në titull.

Z.D.Çaka: Po.

Znj.I.Nano: Atëherë në nenin 14, ankimi ndaj vendimit, propozimi është të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në titull. Sepse në tekstu është Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Votojmë nenin, propozimin për këtë ndryshim duke e votuar nenin 14 me këtë ndryshim. Nëse po, atëherë,

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka!

Me 5 vota pro miratohet nenin 14 me një ndryshim.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Romina Kokoshi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregulator
Dt.30.01.2021*

Neni 15, dispozitat e fundit, ankimi dhe hyrja në fuqi. Kundër këtij vendimi të Komisionit Rregulator do të thotë, mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Të nderuar kolegë votojmë nenin 15, ankimin dhe hyrja në fuqi!

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka!

Me 5 vota pro miratohet edhe nen 15.

Pasi kemi votuar në parim, kemi votuar nen për nen, me 2 ndryshime disa korigjime të vogla, atëherë është momenti të votojmë në tërësi projektvendimin për miratimin e metodologjisë së monitorimit të mediave audio dhe audiovizive. Të nderuar kolegë,

Kush është dakord me projektvendimin në tërësi?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka!

Me 5 vota pro, sa po kemi miratuar vendimin për miratimin e metodologjisë së monitorimit të mediave audio dhe audiovizive!

Nëse ndonjë nga kolegët nuk ka diçka tjeter, për ndonjë çështje jashtë rendit të ditës, unë do të mbyllja mbledhjen duke ju uruar një mesditë të bukur. Faleminderit!

Vendimi nr.2

*Zbardhi materialin e incizuar
Romina Kokoshi*

